

LIGJ
Nr.7723, datë 21.6.1993

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7512, DATË 10.8.1991 "PËR SANKSIONIMIN DHE
MBROJTJEN E PRONËS PRIVATE, TË NISMËS SË LIRË, TË VEPRIMTARIVE PRIVATE
TË PAVARURA DHE TË PRIVATIZIMIT"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991, në nenin 5, në vazhdim të paragrafit të dytë shtohen këto fjalë: "... si dhe të paraqitin lejet përkatëse të lëshuara nga organet kompetente, sipas përcaktimit që bën Këshilli i Ministrave".

Neni 2

Subjektet e përcaktuara në nenin 1 që janë të regjistruara në gjykatë, brenda 2 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të pajisen me lejet përkatëse dhe t'i paraqitin ato në gjykatë. Me kalimin e këtij afati, këto subjekte e humbasin zotësinë për të vepruar.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.583, datë 26.6.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.